



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 08.07..2013  
Nr. 0204-888

**PËR:** Agim Veliu, Kryetar i Komunës së Podujevës  
Hazir Raçi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës

**LËNDA:** KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË  
PODUJEVËS, Nr. 01/123 - 02, Pranuar me datë, 03.07.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr. 01/123 - 02, të miratuar me datë 27.06.2013 nga Kuvendi i Komunës së Podujevës, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin Nr.-3/L-040 për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi Nr. 01/123 - 02, për vënie në diskutim publik të draft Rregullores për Shërbime Publike Komunale.

Me respekt,  
**Slobodan Petrović,**  
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

**Kopje:** Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së  
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së  
Arkivit të MAPL-së



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datum: 08.07..2013  
br. 0204-888

**Za:** Agim Veliu, Gradonačelnik opštine Podujevo  
Hazir Raçi, Predsedavajući Skupštine opštine Podujevo

**Predmet:** Potvrda zakonitosti odluke opštine Podujevo , br. 01/123 - 02, primljeno  
dana , 03.07.2013

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke br. 01/123 - 02, odobreno dana 27.06.2013, **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka 01/123 - 02, za postavljanje na javnoj diskusiji nacrt uredbe o javnim opštinskim uslugama .

Sa poštovanjem.

**Slobodan Petrović,**  
**Zamenik premijera i Ministar MALS-a,**

**Kopije:** Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a  
Rukovodiocima odeljenja MALS-a  
Arhivi MALS-a.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KUVENDI

Në bazë të nenit 12.2 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 15.2 shkronja c të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10 dhe nenit 35 të Rregullores për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes 01/18-02, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 2013, miratoi këtë:

### VENDIM

#### PËR VËNIE NË DISKUTIM PUBLIK TË DRAFT RREGULLORES PËR SHËRBIME PUBLIKE KOMUNALE

##### Neni 1

Vihet në diskutim publik propozim:

- Draft
- Rregullorja për Shërbime Publike Komunale

##### Neni 2

Diskutimi publik zgjatë 30 ditë, ndërsa debati me qytetarë dhe subjekte tjera të interesuara mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, më 17.07.2013, në orën 11,00.

##### Neni 3

Vërejtjet, plotësimet dhe sugjerimet paraqiten ditën e mbajtjes të diskutimit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën e informimit, ndërtesa e Komunës zyra nr. 32.

##### Neni 4

Drafti sipas nenit 1 të këtij vendimi, publikohen në Web faqen zyrtare të Komunës <http://kk.rks-gov.net/podujeve>, ndërsa në formë të shkruar qytetarët, shoqatat joqeveritare, grupet e interesit dhe të gjithë të interesuarit të tjerë mund ta marrin në Zyrën e informimit e cila njëkohësisht është e obliguar të bëjë njoftimet e nevojshme përmes mjeteve të informimit.

**Neni 5**

Diskutimin publik e zbaton Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale e cila është e obliguar të bëjë vlerësimin e propozimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna në aktin e propozuar, për Kuvend të përgatit raport për zbatimin e diskutimit publik si dhe të jap sqarime për arsyeshmërinë për pranimin apo mospranimin e propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

**Neni 6**

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01/123-02  
Podujevë,  
27 qershor 2013

Kryesuesi i Kuvendit  
Mazir Raçi



The stamp is circular with the text 'KOMUNA E KOSOVËS - PODUJEVË' around the perimeter and 'KRYESUESI I KUVENDIT' at the bottom. In the center is a coat of arms. To the right of the stamp is a handwritten signature.